



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 92/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.02.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Anakonda Security” shpk nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur, me nr. REF-79812-11-25-2020 me objekt Loti II “Shërbim shoqërimi i vlerave monetare - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”, me fond limit 1,811,902.56 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Lushnje.

Ankimues: “Anakonda Security” shpk
Adresa: Lagjia “15 Shtatori”, banesë një katëshe, Nr. 32, Tepelenë.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh.a.
Adresa: Lagjia “18 Tetori”, Lushnje.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për

Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”..

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.11.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*, me nr. REF-79812-11-25-2020 me objekt *Loti II “Shërbim shoqërimi i vlerave monetare - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”*, me fond limit 1,811,902.56 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Lushnje.

II.2. Në datën 28.12.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit elektronik të prokurimeve rezulton se në datën 08.01.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Anakonda Security” shpk	1,440,000	lekë	I skualifikuar
2. “Myrto Security” shpk	1,797,279.20	lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 08.01.2021 operatori ekonomik “*Anakonda Security*” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- Sipas vërtetimit të performancës të lëshuar nga Drejtoria Vendore Policisë Fier, subjekti Anakonda Rezulton me 0 Armë krahu dhe 0 armë brezi të rregjistruar në sistemin SIMA. Gjithashtu rezulton me 0 persona të autorizuar për mbajtje armë si edhe rezulton me 0 automjete të blinduar në këtë vërtetim. Duke u bazuar tek ky dokument, kriteri i kapacitetit teknik, pika 3, nënpika c dhe d nuk plotësohen.

II.4.1. Në datën 13.01.2021 operatori ekonomik “*Anakonda Security*” shpk ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

Nepermjet Sistemit te Prokurimeve Elektronike (SPE), me daten 08.01.2021 jemi njohur me njoftimin skualifikimit te ofertes tone. Bazuar ne nenin 63 te LPP dhe nenit 78 te RrPP paraqesim kete ankese prane Autoritetit Kontraktor duke kerkuar: Kualifikimin e ofertes se shoqerise tone per arsye se oferta jone i ploteson te gjitha kriteret e kualifikimit. Duke qene se ne Vertetimin e performances se leshuar nga DVP Fier nuk ishte perfshire i gjithe informacioni ne lidhje me armet, autorizimet e armeve dhe mjeteve te blinduara, ju drejtuam zyrtarisht kesaj te fundit duke kerkuar saktesimin e informacionit ne lidhje me kapacitetet tona teknike. Ne kthimin e pergjigjes nr. 12 prot. date 13.01.2021 nga DVP Fier vertetohet se shoqeria jone disponon 4 arme krahu te gjata 84, jane dhene emrat e punonjesve te cilet jane te pajisur me autorizime per perdorimin e armeve (autorizime keto

qe i kemi paraqitur ne oferte se bashku me dokumentacionin teknik) si dhe disponimin e 2 mjeteve te blinduara dhe nje mjete shoqerues. Sqarojme se sherbimi objekt prokurimi kerkon arme krahu te gjata 84 dhe e dyta ne kriteret e kualifikimit nuk eshte kerkuar numer konkret ne lidhje me armet. Sa me siper kerkojme nga KSHA marrjen parasysh te ketij sakesimi informacioni leshuar nga DVP Fier dhe kualifikimin e ofertes se shoqerise tone duke qene se i ploteson te gjitha kriterete e kualifikimit.

II.4.2. Në datën 18.01.2021 me shresën nr. 811/19 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.4.3. Në datën 21.01.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor si më poshtë vijon:

Nepermjet Sistemit te Prokurimeve Elektronike (SPE), me daten 08.01.2021 jemi njohur me njoftimin skualifikimit te ofertes tone. Bazuar ne nenin 63 te LPP dhe nenit 78 te RrPP paraqitem ankesen nr. 13 prot. date 13.01.2021 prane Autoritetit Kontraktor duke kerkuar: Kualifikimin e ofertes se shoqerise tone per arsye se oferta jone i ploteson te gjitha kriteret e kualifikimit. Ne date 20.01.2021 u njohem me shkresen nr. 811/19 prot. date 18.01.2021 me ane te te ciles AK nuk e ka marre parasysh ankesen tone. Ne keto kushte dhe bazuar ne nenin 63 te LPP dhe nenit 78 te RrPP paraqesim kete ankese prane KPP si organi me i larte vendim-marres ne fushen e prokurimeve publike, me te njejtin objekt ankimimi. Duke qene se ne Vertetimin e performances se leshuar nga DVP Fier nuk ishte perfshire i gjithe informacioni ne lidhje me armet, autorizimet e armeve dhe mjeteve te blinduara, ju drejtuam zyrtarisht kesaj te fundit duke kerkuar sakesimin e informacionit ne lidhje me kapacitetet tona teknike. Ne kthimin e pergjigjes nr. 12 prot. date 13.01.2021 nga DVP Fier vertetohet se shoqeria jone disponon 4 arme krahute gjata B4, jane dhene emrate punonjesve te cilet jane te pajisur me autorizime per perdorimin e armeve (autorizime keto qe i kemi paraqitur ne oferte se bashku me dokumentacionin teknik) si dhe disponimin e 2 mjeteve te blinduara dhe nje mjete shoqerues. Sqarojme se sherbimi objekt prokurimi kerkon arme krahu te gjata B4 dhe e dyta ne kriteret e kualifikimit nuk eshte kerkuar numer konkret ne lidhje me armer.

KSHA duhej te kishte marre ne konsiderate informacionin e leshuar nga DVP Fier dhe jo te na shpjegonte pse ka vendosur KVO per skualifikimin tone. Vete organi kompetent shtetror qe ka leshuar vertetimin e performances ka saktësuar informacionin ne lidhje me kapacitetet teknike te shoqerise tone ne Qarkun Fier, kapacitete keto qe plotesojne 100% kriteret e kualifikimit. Nqs se KSHA do te kishte dyshime mbi saktesine e te dhenave te kesaj shkrese duhej ti ishte drejtuar zyrtarisht DVP Fier. Kjo eshte dhe detyra e KSHA pra verifikimi i pretendimeve te ankimuesit.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.68 prot datë 03.02.2021 protokolluar me tonën me nr. 121/2 prot datë 05.02.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e

Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Anakonda Security” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Sipas vërtetimit të performancës të lëshuar nga Drejtoria Vendore Policisë Fier, subjekti Anakonda Rezulton me 0 Armë krahu dhe 0 armë brezi të rregjistruar në sistemin SIMA. Gjithashtu rezulton me 0 persona të autorizuar për mbajtje arme si edhe rezulton me 0 automjete të blinduar në këtë vërtetim. Duke u bazuar tek ky dokument, kriteri i kapacitetit teknik, pika 3 , nënpika c dhe d nuk plotësohen”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Loti II pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet te paraqese Vertetim Performance nga Drejtorite Vendore te Policise ku ndodhen objektet ku do te kryhet sherbimi, lëshuar brenda 1 (nje) muaji nga data e hapjes se ofertave, ku te jepet informacioni si me poshte:

- a. Per numrin e punonjesve te sherbimit te licensuar jo me pak se 3 (tre).*
- b. Te kete 5 operator ne Qendren e Kontrollit.*
- c. Per numrin e armeve te krahut dhe armeve te brezit ne pronesi.*
- d. Per numrin e punonjesve te sherbimit te pajisur me autorizim per mbajtje arme, jo me pak se 3 (tre) punonjes.*
- e. Qe ka jelek antiplumb, radiokomunikimi, hekura lidhes, shkopinj gome.*
- f. Nuk ka mase administrative per operatorin ekonomik (Subjektin) gjate periudhes 1 Janar 2019 e ne vazhdim.*

III.1.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Anakonda Security” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Performance me Nr. 2327 prot, datë 23.12.2020, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier për subjektin “Anakonda Security” shpk ku jepen ndër të tjera të dhëna si më poshtë:

- Subjekti “Anakonda Security” shpk, nënkategoria 1.3.A, me titullar subjekti z. Alfred Shehu, dhe drejtues teknik Remzi Bani, nënkategoria 1.3.A dhe drejtues teknik Enver Meçaj, nënkategoria 1.3.B, është i pajisur me licencë me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 310/10 dhe 310/11 prot, datë 18.07.2019.
- Subjekti “Anakonda Security” shpk ka miratuar Qendrën e Kontrollit në selinë qendrore në DVP Fier me nr. 995 prot datë 01.06.2020 me adresë Lagjia Kongresi Lushnjes, Bashkia Lushnje.
- Numri i punonjësve të shërbimit të certifikuar 9.
- Numri i punonjësve të shërbimit me detyrë Truprojë 0.
- Numri i armëve të krahut të rregjistruara në sistem SIMA 0.
- Numri i armëve të brezit të rregjistruara në sistem SIMA 0.
- Numri i personave të pajisur me autorizim për mbajtje arme 0.
- Numri i mjeteve speciale dhe llojet e mjeteve speciale që kanë administrim, 9 shkopa gome, 3 radio komunikimi, 9 jelek antiplumb, 9 hekura lidhës.
- Numri i automjeteve të shërbimit 1 automjet.
- Numri i automjeteve të blinduara 0 gjithësej.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Aftësia teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.1.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.5. Në nenin 28 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.6. Neni 27, pika “c” e këtij ligji parashikon se “[...] punonjësi i shërbimit ka përgjegjësi të mbajtje, sipas rregullores, armatimit personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shënjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi”.

Ndërsa sipas nenit 34, po këtu, thuhet se “[...] në veprimtarinë e sigurisë fizike të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje, miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi [...]”.

III.1.7. Referuar ligjit 74/2014 datë 10.07.2014 “Për armët” neni 5 i tij “Kategorizimi i armëve” parashikon shprehimisht se:

1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si më poshtë: 1.2. Armët e kategorisë “B” janë:

- a) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautematike apo vetërimbushëse (B1);
- b) armët e zjarrit të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore (B2);
- c) armët me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 cm (B3);
- ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautematike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të mbajnë më tepër se tre fishekë (B4);
- d) armët e zjarrit të gjata gjysmautematike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të pranojnë deri në tre fishekë. Kur mbushësi i tyre ndërrohet, këto armë mund të konvertohen, me ndihmën e një mjeti të zakonshëm, dhe të pranojnë më tepër se tre fishekë (B5);
- dh) armët e zjarrit të gjata gjysmautematike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar, të gjatë deri në 60 cm (B6);
- e) armët e zjarrit pneumatike, me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7).

III.1.8. Gjithashtu referuar nenit 7 “E drejta e pronësisë mbi armët”, të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht se:

- 1. Armët e kategorisë “A”, në kuptim të këtij ligji, janë vetëm pronë e shtetit, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska dhe të pajisura me shënjestër optike.
- 2. Armët e kategorive “B”, “C” dhe “D”, në kuptim të këtij ligji, mund të jenë në pronësi private e shtetërore.
- 3. Veprimet juridike për kalimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera mbi armët kryhen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.
- 4. Për sa nuk parashikohet në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Kodit Civil. [...].

III.1.9. Ndërsa neni 8 i ligjit “Regjimi juridik për kategoritë e armëve” përcaktohet se: Për armët e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, ka regjim të veçantë juridik duke respektuar përfshirjen në kategoritë e ndryshme, si më poshtë:

1. Në kategorinë "A" përfshihen armë, të cilat nuk lejohen të përdoren dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska, të pajisura me shënjestër optike, që në kuptim të këtij ligji nuk janë të ndaluara. Për këto armë, pajisen me autorizim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, ata shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë aftësinë e ushtrimit të sportit të qitjes professioniste ose gjuetisë, sipas vërtetimit/lejes përkatëse nga ministria përgjegjëse për sportet ose ajo për mjedisin.

2. Në kategorinë "B" përfshihen armë, për të cilat lëshohet autorizim sipas këtij rregulli:

a) për armët e kategorisë "B1", pajisen me autorizim personat që për shkak të detyrës shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, sipas legjislacionit në fuqi, personat që plotësojnë kriteret për mbajtjen e armës, si dhe ata të cilëve për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas këtij ligji;

b) për armët e kategorisë "B4", pajisen me autorizim personat që për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private, u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas dispozitave të këtij ligji.

III.1.10. Gjithashtu referuar Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm Nr. 130, datë 05.03.2018, në Kreun VI “Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të sektorit banker, sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materialet dhe sendet e çmuara gjatë transportit” në gërmën B parashikohet se:

1- Transportimi i vlerave monetare kryhet nga subjektet e SHPSF-së të pajisura me licencë të nënkategorisë 1.3.B, të cilat kanë në pronësi mjete të blinduara të certifikuar sipas standardeve të BE-së, të projektuara për transportin e vlerave monetare, sendeve të çmuara, si dhe për transportin e punonjësve të SHPSF-së (përveç Bankës së Shqipërisë).

C. Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese

Për transportin e vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara dhe për transportin e punonjësve

të SHPSF-së përdoren automjete të blinduara sipas kategorizimit të mëposhtëm:

1. Kategori A: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë

deri në 10.000.000 lekë realizohet me:

a) Një automjet i blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të

mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-3;

- Pjesa ku vendosen mbajtësit e vlerave monetare të jetë pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

b) Jo më pak se dy punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti).

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së.

- d) *Sistem gjurmimi GPS.*
 - e) *Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar.*
 - f) *Kamera për lexim automatik të targave.*
2. *Kategoria B: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 10.000.000 lekë deri në 25.000.000 lekë realizohet me:*
- a) *Një automjet i blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave monetare nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë):*
 - *Niveli i blindimit të automjetit BR-3;*
 - *Pjesa ku vendosen mbajtësit e vlerave monetare të jetë pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.*
 - b) *Jo më pak se tre punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjete).*
 - c) *Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së.*
 - d) *Sistem gjurmimi GPS.*
 - e) *Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar.*
 - f) *Kamera për lexim automatik të targave.*

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit

III.1.12. Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Anakonda Security” shpk me anë të dokumentacionit të paraqitur dhe konkretisht vërtetimin e performancës të paraqitur me nr 2327, datë 23.12.2020, lëshuar nga Drejtoria Vendore Policisë Fier, nuk dëshmon se disponon jo më pak se tre armë brezi, dhe tre punonjës shërbimi të pajisur me autorizim për mbajtje arme, pasi nga verifikimi i vërtetimit të performancës në përmbajtjen e informacionit Drejtoria Vendore e Policisë Fier është

shprehur: “Numri i armëve të krahut të regjistruara në sistemin SIMA 0 (zero), Numri i armëve të brezit të regjistruara në sistemin SIMA 0 (zero), Numri i personave të pajisur ne autorizim për mbajtje arme 0 (zero)”

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur nuk ka arritur të vërtetojë përmbushjen e kapacitetit teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor në DT. Lidhur me sa më sipër, KPP gjen me rast të sqarojë se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Paraqitja pranë autoriteteve kontraktore, apo pranë KPP-së, e dokumentacionit të kërkuar në DT, pas hapjes së ofertave, është i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur kemi të bëjmë me sqarime të cilat kërkohen nga vetë autoriteti kontraktor në mbështetje të nenit 53, pika 1 të LPP. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Anakonda Security” sh.p.k ka bashkengjitur shkresës nr. 121 prot., datë 21.01.2021 me objekt: “Ankesën”, depozituar në KPP, ka paraqitur edhe kopjen e shkresës me nr.prot. 12, datë 13.01.2021, të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, në të cilën vërtetohet pretendimi i parashtruar prej tij, por në rastin konkret nuk ndodhemi në kushtet e sqarimit dhe autoriteti kontraktor me të drejtë nuk ka kërkuar sqarime, por e ka konsideruar dokumentacionin e paraqitur nga ana e ankimuesit në tender të parregullt, pasi ai (vërtetimi i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier), nuk paraqet paqartësi që duhen sqaruar, por paraqet mangësi në përmbajtje. Ndaj referuar interpretimit ligjor të mësipërm operatori ekonomik “Anakonda Security” shpk nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor armët e krahut dhe punonjësit e shërbimit të autorizuar për mbajtje arme. Komisioni gjykon se shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në bazë të dokumentacionit të paraqitur në sistem, e si rrjedhim cdo dokument tjetër që nuk është paraqitur në këtë mënyrë, do të konsiderohet i pavlefshëm.

Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Sqarojmë, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (numrin e armëve dhe punonjësit e shërbimit të pajisur me autorizim për mbajtje arme), në përputhje me volumin e përcaktuar

në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e mospërbushjes së kriterit të vecanta të kualifikimit pasi ky i fundit me anë të dokumentacionit të paraqitur nuk arrin të përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8/2, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Anakonda Security” sh.p.k nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri.

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Anakonda Security” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur, me nr. REF-79812-11-25-2020 me objekt Loti II “Shërbim shoqërimi i vlerave monetare - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”, me fond limit 1,811,902.56 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Sh.a Ujësjetës Kanalizime Lushnje.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 121 Protokoll; Datë 21.01.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri